Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA
Pranuar: Primljeno Më/Dana 29.09.2022
Nr.i organit Org.Broj | Numri/Broj | Shtojcë Prilog | Vlera Vrednost
01-110/05-1066

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 12, pika d, neni 40, pika j të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 7 të Ligji Nr. 04/L-010 për Bashkëpunim Ndërkomunal dhe nenit 36, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë 01 Nr. 013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 28.09.2022, merr këtë:

# VENDIM

**Për nxitjen e bashkëpunimit ndërkomunal të kryetarit të Komunës së Vitisë me Komunën e Kllokotit, në fushat e përgjithshme, si: infrastrukturë rrugore, ekonomi, bujqësi, shëndetësi, arsim, shërbime të zjarrfikëseve, ofrimi i shërbimeve juridike**

**Neni 1**

Me këtë, Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për nismën e bashkëpunimi ndërkomunal me Komunën e Kllokotit.

**Neni 2**

Bashkëpunimi do të bëhet në fushat e përgjithshme, si: infrastrukturë rrugore, ekonomi, bujqësi, shëndetësi, arsim, shërbime të zjarrfikëseve, ofrimi i shërbimeve juridike.

**Neni 3**

Detajet e bashkëpunimit do te përcaktohen me marrëveshje të bashkëpunimit.

**Neni 4**

Ky vendim prodhon efekt juridike deri në përfundim të këtij mandati të kryetarit të Komunës së Vitisë.

**Neni 5**

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8 lidhur me neni 9 të Rregullores Nr.10/2019 për procedurat e hartimi dhe publikimi të akteve të Komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:
1. Zyrës së Kryetarit;
2. MAPL-së; dhe
3. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
KRYESUESI
Bekim Azizi